



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



| |
|--|
| REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA E KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO |
| Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit Regulatorni Autoritet za Usluge Vode Water Services Regulatory Authority |
| Nr. prot./Prot. B / Prot. No. <u>672</u> |
| Titulli/Subject/Objekt <u>D</u> |
| Udhë. Shfaq. No. <u>28/12/2016</u> |
| Udhë. No. <u>28/12/2016</u> |
| PROROGIM I PUNËSIAVE - PUNËSIAVE |

UA – 01/2017
27.12.2016

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (në tekstin e më tutjeshëm: “ARRU”),

Në pajtim me autoritetin e dhënë me Nenin 14 të Ligjit Nr. 05/L-042, Për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit .

Pas konsultimeve me Ministrinë e Financave lidhur me dëgjimet buxhetore dhe miratimit të buxhetit të ARRU-së për vitin 2017 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës

Me qëllim të përcaktimit të lartësisë së taksës së licencimit, ose metodës së kalkulimit të kësaj takse që është e pagueshme sipas nenit 14 pika 1 dhe 2 të Ligjit, si dhe nenit 6 pika 2.2

Drejtori i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit nxjerrë Udhëzimin Administrativ si vijon:

Neni 1 Përkufizimet

1.1 Në këtë Udhëzim Administrativ:

“Ofrues i Shërbimeve” Ofruesit e Shërbimeve të Ujës-jellësit, Ujërave të Ndotura dhe Furnizuesit e Ujit me Shumicë, krejt së bashku Ofrues të Shërbimeve, dhe në rast të bashkimit (shkrirjes) të ndonjë Ofruesi të Shërbimeve me një ose më tepër Ofrues të Shërbimeve, pasardhësin e tij.

- 1.2 Përveq nëse ndryshe është përkufizuar me këtë Udhëzim Administrativ, fjalët që fillojnë me shkronjë të madhe do ta kenë kuptimin e që iu është dhënë në Ligj.

Neni 2

Taksa Vjetore e Licencimit

- 3.3. Taksa vjetore e licencimit për vitin që fillon me 1 janar 2017 e pagueshme për Ofruesit e Shërbimeve të në pajtim me Nenin 14 të Ligjit do të jetë **1.12 %** të faturimit vjetor bruto të raportuara në pasqyrat e te ardhurave të tyre për vitin paraprak të atij Ofruesi të Shërbimeve të Ujit e që është vlera e dhënë në Shtojcën 2, e llogaritur në pajtim me Nenin 14 të Ligjit si vijon:

$$\mathbf{X = B \times t / T}$$

Ku:

X = Vlera e Taksës Vjetore të Licencimit e pagueshme nga secili Ofrues i Shërbimeve

B = Shpenzimet e parapara të ARRU për vitin 2017 (shih Shtojcën 1)

t = Qarkullimi vjetor bruto i Ofruesit të Shërbimeve për vitin paraprak (shih Shtojcën 2)

T = Shuma e qarkullimit vjetor të të gjithë Ofruesve të Licencuar të Shërbimeve në vitin paraprak (shih Shtojcën 3)

- 3.4. Në rast se një Ofrues i Shërbimeve është bashkuar me një apo më tepër Ofrues të Shërbimeve të Ujit, pasardhësi i tij duhet të paguajë taksën vjetore të licencimit që është e pagueshme nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit që është bashkuar (shkrirë).
- 3.5. Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, dhe furnizuesit të ujit me shumicë, të Licencuar nga ARRU janë të obliguar të paguajnë Taksën Vjetore të Licencimit e cila është e ndarë në dymbëdhjetë (12) këste të barabarta në çdo fillim të muajit të vitit kalendarik, më së voni deri me datën pesë (5).


Neni 3
Taksa e Aplikimit

3.1. Aplikuesi i paguan Autoritetit taksën e pakthyeshme, në vlerë prej 200.00€, për paraqitjen e aplikacionit në ditën kur aplikacioni për lëshimin ose përtëritjen e licencës për shërbime i është dorëzuar Autoritetit, sipas Rregullores Nr. 05/2016, për licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë.

Neni 4
Hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi Administrativ

Ky Udhëzim Administrativ do të hyjë në fuqi më 01 janar 2017.

Raif Preteni, Drejtor ARRU-së



Bashkangjitur:

Shtojca 1: Shpenzimet ARRU-së të Aprovuara me ligjin e buxhetit 2017

Shtojca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve në 2015 dhe

Lartësia e Taksës Vjetore të Licencimit për Ofruesit e Shërbimeve për 2017

Shtojca 1: Shpenzimet Totale të ARRU- së të Aprovuara për vitin 2017

| SHPENZIMET TOTALE TË ARRU NË 2017 | |
|---|-------------------|
| 1. Shpenzimet e Personelit | 217,736.00 |
| 2. Shpenzimet e Mallërave dhe Shërbimeve | 134,495.00 |
| 3. Shpenzimet e Shërbimeve Publike | 6,503.00 |
| Gjithësejt Shpenzimet e ARRU | 358,734.00 |

Shtojca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve në vitin 2015 të audituar nga ARRU si dhe Taksa vjetore e Licencimit per vitin 2017

| SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA DHE UJIT ME SHUMICË 2015 | | | TAKSA VJETORE PER OFRUESIT E SHERBIMEVE 2017 | | |
|---|-----------|-------------------------------|---|-----------|---------------------------|
| Emri i Ofruesit të Shërbimeve | Regjioni | Qarkullimi bruto vjetor (EUR) | Emri i Ofruesit te Sherbimeve | Regjioni | Lartesia e takses vjetore |
| Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "PRISHTINA" | Prishtina | 13,154,783.00 | Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "PRISHTINA" | Prishtine | 147,333.57 |
| Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "BIFURKACIONI" | Ferizaj | 2,258,,510.00 | Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "BIFURKACIONI" | Ferizaj | 25,295.31 |
| Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "RADONIQI" | Gjakovë | 3,865,322.50 | Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "RADONIQI" | Gjakove | 43,291.61 |
| Ofruesi i Ujit me shumice "IBER-LEPENCI" | Prishtinë | 489,595.00 | Ofruesi i Ujit me shumice "IBER-LEPENCI" | Prishtine | 5,483.46 |
| Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "UJESJELLSI REGJIONAL" | Mitrovicë | 2,674,645.00 | Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "UJESJELLSI REGJIONAL" | Mitrovicë | 29,956.02 |
| Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDRODRINI" | Pejë | 3,537,564.00 | Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDRODRINI" | Peje | 39,620.72 |
| Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROREGJIONI" | Prizren | 4,189,972.16 | Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROREGJIONI" | Prizren | 46,927.69 |
| Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROMORAVA" | Gjilan | 1,975,799.00 | Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROMORAVA" | Gjilan | 22,128.95 |
| Totali – Ofruesit e Ujit dhe Ujërave të Zeza | | 32,146,190.66 | Total taksa vjetore 2017 | | 360,037.34 euro |